



ДРЖАВЕН ЗАВОД ЗА РЕВИЗИЈА
ENTI SHTETËROR I REVIZIONIT
STATE AUDIT OFFICE

Abstrakti i raportit përfundimtar i revizionit

Subjektet kyçe të përfshira me raportin e revizionit:

Ndërmarrja Publike „Ujësjetllësi” Kumanovë

Lënda e revizionit:

Revizioni i raporteve financiare bashkë me revizionin e pajtueshmërisë për vitin 2020

Qëllimi i revizionit:

Nëse raporti financiar është i liruar nga paraqitjet e gabuara materialisht dhe nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet në to janë në pajtim me rregullativën ligjore.

Gjendjet kyçe të konstatuara:

- nuk janë të rregulluara të drejtat dhe detyrimet e ndërsjella ndërmjet ofruesit Ekonomia e ujrave “Fusha e Kumanoves dhe Likovës” dhe shfrytëzuesit të shërbimeve NP “Ujësjetllësi” Kumanovë;
- obligimet ndaj Buxhetit të RVM-së në bazë të kompensimit për shfrytëzimin e ujit dhe shkarkimin e ujit nuk janë paguar në shumë prej 28.713 mijë denarë;
- sistemi i furnizimit me ujë regjistron një përqindje të lartë prej 55% humbje uji.

Mendimi i dhënë*:

Shprehëm mendim të pavolitshtëm për vërtetësinë dhe objektivitetin e raporteve financiare për vitin 2020 dhe për pajtueshmërinë me rregullativën ligjore, udhëzimeve dhe politikave të vendosura.

Rekomandimet kyçe:

- ndërmarrja të lidhë marrëveshje me ofruesin e shërbimeve për rregullimin e të drejtave dhe detyrimeve reciproke;
- shlyerja me kohë e detyrimeve në bazë të kompensimit për shfrytëzimin dhe shkarkimin e ujit;
- eliminimi i shkaqeve që kontribuojnë në humbjen e ujit në sistemin e ujësjetllësit.

Dobësitë kyçe të sistemit:

/

Vërejtjet e marra të draft-raportit:

Nga personi i autorizuar i NP „Ujësjetllësi” Kumanovë janë marrë vërejtje të Draft-Raportit të revizorit të autorizuar shtetëror nr. 17-181/11 prej 05.11.2021.

Përgjigjet e vërejtjeve të marra:

Vërejtjet janë shqyrtuar dhe nuk janë pranuar për arsye se nuk janë ofruar dëshmi shtesë që do të ndikonin në ndryshimin e konstatimeve në raport.

* pozitive, me rezervë të pavolitshtëm, të përmbajtur